

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Nebojsa Boriqiq, kryetar kolegji, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit A.S., nga fshati S., komuna P., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses të të dënuarit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-kolegjit shqyrtues Kp.nr.1572/2017 datë 15.01.2018, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.50/2018 të dt.26.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 07.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses të të dënuarit A.S., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - kolegjit shqyrtues Kp.nr.1572/2017 datë 15.01.2018 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.50/2018 të datës 26.01.2018.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.1004/2013 të datës 28.01.2015, i dënuari A.S. është shpallur fajtor për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK dhe është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve. Kundër këtij aktgjykimi nuk ka pasur ankesë dhe aktgjykimi e ka marrë formën e prerë më datë 04.05.2015.

Gjykata Themelore në Prishtinë-kolegji shqyrtues, me aktvendimin Kp.nr.1572/2017 datë 15.01.2018, e ka hedhur kërkesën e mbrojtësit të dënuarit për rishikim të procedurës penale, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.1004/2013 të datës 28.01.2015 si të palejuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.nr.50/2018 të dt. 26.01.2018, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të dënuarit A.S. të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë KP.nr.1572/17 të datës 15.01.2017.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP.nr.1572/2017 të datës 15.01.2018, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit A.S., av. F.G.-B. nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 16 i KPPK-së, nenit 384 par.2 pika 2.2 si dhe nenit 479 par.1 të KPRK si dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë ta hedhë si të pabazuar, kurse ankesën e të dënuarit A.S. ta aprovojë si të bazuar duke ndryshuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të njëjtit ti ndërpritet vuajtja e dënimit konform dispozitave të kodit procedurës penale dhe ti jepet mundësia ligjore që të ushtroj ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.1004/2013 datës 28.01.2015.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses të të dënuarit, ka dhënë Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.II.nr.52/2018 e datës 28.03.2018, në të cilën ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa e mbrojtëses të të dënuarit nuk është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësja e të dënuarit A.S., pretendon se janë shkelur dispozitat e procedurës penale për faktin se të dënuarit i janë mohuar të drejtat e parapara me akte juridike pasi që nuk janë respektuar të drejtat për të ushtruar ankesë. Më tutje në kërkesë pretendohet se aktgjykimi i shkallës së parë ka marrë formën e prerë pa garanci procedurale-i dënuari nuk është njoftuar konform dispozitave të KPPRK nga neni 478 par.3

pika 2 dhe neni 479 par.1 pika 2 të KPPRK, për çka aktvendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit është i paqëndrueshëm.

Më tej në kërkesë pretendohet se momenti i vënies në dizeni nga ana e të dënuarit për aktgjykimin e shkallës së parë ndodhi me rastin e mbërritjes së tij në aeroportin e Prishtinës, me ç rast i dënuari arrin të kuptoj se ndaj tij ka një vendim gjyqësor që duhet të ekzekutohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pretendimet e kërkesës janë të pabazuara. Sa i përket pretendimit se është shkelur dispozita e nenit 479 par.1 të KPPRK, ky pretendim nuk është i bazuar për arsye se nga shkresat e lëndës - procesverbali i vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor i mbajtur me datën 27.01.2015, rezulton se i dënuari A.S., është njoftuar se shpallja e aktgjykimit lidhur me këtë çështje penale do të bëhet me datë 28.11.2015 në ora 11.00, ndërsa nga arsyetimi i aktgjykimit të shpallur me këtë datë rezulton se kryetarja e trupit gjykues ka shpallur publikisht aktgjykimin në prezencë të palëve përkatësisht edhe në prezencën e të dënuarit me arsyetim të shkurtër duke i njoftuar mbi rëndësinë e dënimit me burg dhe duke i udhëzuar në të drejtën e ankesës. Po ashtu nga fletë kthesa që gjendet në shkresat e lëndës rezulton se aktgjykimi PKR.nr.1004/2013 i datës 28.01 2015, është dorëzuar me postë, me datë 15 prill në adresën A.H.S., në fshatin S., komuna P.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktvendimet e atakuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ashtu siç pretendon mbrojtja. Aktvendimi i shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, përshkrimi i dhënë në dispozitiv është konkret dhe i kuptueshëm, me asgjë i njëjti nuk sjellët në dyshim, ndërsa arsyetimi përmban arsye të duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje juridiko penale.

Edhe pse në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësja e të dënuarit thirret në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, ajo në pjesën dërmuese të pretendimeve fokusohet në elaborimin e çështjeve faktike, pretendime të cilat nuk mund të jenë bazë për këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik konform dispozitës së nenit 432 par.2 të KPPK-së.

Duke marr parasysh këtë gjendje të çështjes, kjo Gjykatë vlerëson se te dy aktvendimet si ai i shkallës së parë, ashtu edhe shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale, ashtu siç pretendon mbrojtësja e të dënuarit, se te dy aktvendimet janë të qarta, të kuptueshme dhe të

bazuara në ligj, andaj konform dispozitës së nenit 437 të KPPK-së, është refuzuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.73/2018, më datë 7.05.2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Nebojsa Boriqiq